

NJOFTIM NGA KOMISIONERI I PËRKOHSHËM PËR MEDIA:

STRATEGJI E RISHQYRTUAR PËR LICENCIM

11 Dhjetor 2003

Komisioneri i Përkohshëm për Media sot bëri publike një Strategji të Rishqyrtuar për Licencimin e Radiove dhe Televizioneve. Strategjia mban moratoriumin aktual sa i përket dhënjës së licencave të reja për radio dhe TV stacione, mirëpo lejon disa përjashtime për dy kategori të aplikimit:

- (1) Aplikacionet për marrjen e licencave për regjionet të cilat momentalisht nuk janë mirë të mbuluara apo fare nuk kanë mbulim nga mediat lokale dhe
- (2) Aplikacionet për stacione multietnike

Ju lutem që këtë strategji ta gjeni të bashkangjitur në formatin Microsoft Word.

Me efekt të menjëhershëm, KPM do të pranojë aplikacionet për marrjen e licencave për këto kategori. Prapsepapë, do të lëshohet vetëm një numër i kufizuar i licencave të reja. Kandidatët duhet të tregojnë se kanë aftësi profesionale për të themeluar dhe menagjuar një stacion profesional si dhe ata duhet të dëshmojnë që kanë mundësi për ta financuar një stacion të tillë.

Kandidatët duhet të drejtohen në zyrën e KPM-së, në adresën Rruga Gazmend Zajmi Nr.1, 38000 Prishtinë; përmes faksit në numrin (038) 245-034; apo në e-mail adresën e KPM-së: tmc@omik.org

Institucioni i Komisionerit të Përkohshëm për Media u themelua më 17 qershor 2000 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Është organ i pavarur që ka përkrahjen administrative të Misionit të OSBE-së në Kosovë. KPM vepron në Kosovë si agjencion rregullues i subjekteve transmetuese përderisa Parlamenti i Kosovës do të themelojë Komisionin e Pavarur për Media i cili do të jetë i përhershëm.